



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PREDSIEDNICA

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**KOMENTET E PRESIDENTES SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË KËRKESËN
NR. KO 265/25**

Prishtinë

9 shtator 2025

HYRJE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenet 4 (3) dhe 84 (2) të saj e ka përcaktuar shprehimisht rolin e Presidentes si “garantuese e funksionimit kushtetues dhe demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës.” Në interpretimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin nr. KO 103/14, “**mandati i Presidentit të Republikës është i pacenueshëm** për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe **për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues**”, duke shtuar tutje se “**është përgjegjësi e Presidentit ta ruajë stabilitetin e vendit**”.

Udhëhequr nga këto autorizime kushtetuese, paraqes komentet e mëposhtme në rastin nr. KO 265/25.

Siç do të argumentohet më në detaje, në vijim të këtij dokumenti, funksionimi efektiv i institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti i Kuvendit si ushtrues i sovranitetit përmes përfaqësuesve të zgjedhur të popullit [Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 2 (1); Aktgjykimi në rastin nr. KO 124/25, paragrafi 105], është qenësor për ruajtjen e rendit kushtetues, por edhe të vetë konceptit të shtetit sovran dhe funksional të Republikës së Kosovës, të mishëruar në nenet 1 dhe 2 të Kushtetutës. Prandaj, në kushtet kur bllokohet konstituimi i Kuvendit, pamundësohet përfaqësimi legjitim i qytetarëve në institucionin më të lartë përfaqësues, e rrjedhimisht edhe ushtrimi i sovranitetit.

Prandaj, mbrojtja e sovranitetit me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë ndërlidhet poashtu me Kuvendin si bartës i tij. Në thelb, mungesa e ushtrimit efektiv të sovranitetit nënkupton edhe mungesën e kapacitetit shtetëror për të vepruar institucionalisht dhe për t'i përmbushur funksionet themelore të shtetit. Nëse përfaqësimi demokratik dhe institucional nuk garantohen në praktikë, atëherë rrezikohet jo vetëm rendi kushtetues, por edhe vetë koncepti i shtetit sovran dhe funksional të Republikës së Kosovës.

Tutje, bllokimi i konstituimit të Kuvendit për shkak të moszgjedhjes së vetëm një nënkryetari gjatë seancës konstituive, përderisa Kryesia ka kuorum, do ta cenonte në mënyrë serioze jo vetëm funksionalitetin institucional, por edhe vetë themelet dhe vlerat mbi të cilat është ndërtuar Republika e Kosovës. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në vlera dhe parime themelore të tilla si: demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut, sundimi i ligjit dhe ndarja e pushteteve. Këto vlera nuk janë thjesht elemente normative të listuara në Kushtetutë, por përbëjnë vetë themelin kushtetues dhe shtetëror të Republikës së Kosovës.

Prandaj, në vijim do të argumentohet se: (I) të drejtat e garantuara në Kushtetutë bartin detyrimin e pandashëm për të mos abuzuar me to, dhe (II) Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk duhet të bllokohet si pasojë e veprimeve të cilësdo parti politike apo komuniteti.

I. Parimi i mosabuzimit të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është ndër kushtetutat më të avancuara sa i përket të drejtave të komuniteteve joshumicë, në linjë të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e pakicave, madje edhe duke i tejkaluar ato. Aktualisht, nuk ka asnjë kushtetutë në kontinentin evropian që u jep më shumë të drejta komuniteteve joshumicë sesa ajo e Kosovës.

Në këtë drejtim, përveç Kapitullit II, i cili garanton të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim, Kushtetuta përmban edhe një Kapitull (III) të tërë të dedikuar vetëm për të drejtat e komuniteteve joshumicë. Megjithatë, **neni 57, paragrafi 4 i Kushtetutës**, përcakton se ushtrimi i këtyre të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre *“bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve”*.

Ky nen i Kushtetutës ngërthen në vete dy parime themelore, të cilat janë parakushte për realizimin e të drejtave: së pari, detyrimin për të vepruar në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, dhe së dyti, detyrimin që nëpërmjet ushtrimit të të drejtave vetanake, të mos shkelen apo cenohen të drejtat e të tjerëve. Sa i përket detyrimit të parë, është esenciale që partitë apo komunitetet që përfitojnë nga të drejtat e parapara me Kushtetutë të plotësojnë disa nga kushtet bazike për funksionim në Republikën e Kosovës, që përfshijnë njohjen e shtetit të Kosovës, sovranitetit, integritetit territorial e parimit të unitaritetit të shtetit, njohjen e simboleve shtetërore, respektimin e rregullimit kushtetues, veprimtarinë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, si dhe parimet e tjera, të parapara në veçanti në Kapitullin I të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, sa i përket kriterit të dytë, pra që ushtrimi i të drejtave të komuniteteve të mos rezultojë me cenim të të drejtave të tjerëve, është me rëndësi që në rastin konkret të shihet dëmi i pariparueshëm që po i bëhet procesit të konstituimit të institucioneve në tërësi duke i bllokuar ato për një pozitë nënkryetari, por po ashtu mohimi i ushtrimit të funksionit që po u bëhet të gjithë deputetëve të tjerë, të cilët, siç është konstatuar edhe nga vetë Gjykata në rastet nr. KO 124/25, KO 193/25 dhe KO 196/25, nuk po kanë mundësi ta ushtrojnë funksionin e tyre si përfaqësues të sovranit, e si rrjedhojë, nuk kanë mundësi të ushtrojnë sovranitetin shtetëror [Aktgjykimi në rastin Nr. KO 124/25, paragrafi 105], ta mbrojnë sistemin kushtetues, t'i zgjedhin institucionet e tjera, të miratojnë ligje si dhe të marrin vendime të tjera në interes të qytetarëve e të shtetit [Aktgjykimi në rastin Nr. KO 193/25 dhe KO 196/25, paragrafi 155].

Rrjedhimisht, bllokimi i Kuvendit për shkak të pozitës së një nënkryetari që i takon komunitetit joshumicë serb, përderisa Kryesia e Kuvendit ka kuorum dhe të gjithë deputetët e kanë dhënë betimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë i cenon të drejtat e të tjerëve. Në rastin konkret, cenimi nuk është vetëm në raport me deputetët e tjerë të Kuvendit, të cilëve po u pamundësohet ushtrimi i funksionit, por edhe me të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët që nga dhjetori i vitit 2024 nuk e kanë institucionin e tyre përfaqësues, pra Kuvendin, funksional e duke punuar në interes të tyre.

Tutje, neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Barazia para ligjit], si parim themelor i përcaktuar në këtë Kushtetutë, është i ndërlidhur në veçanti me autoritetet publike. Në këtë drejtim, Komentari i Kushtetutës, përderisa trajton barazinë para ligjit në kontekst të pushtetit legjislativ, gjithashtu sqaron se: “për pushtetin e legjislativit, parimi i barazisë nënkupton obligimin për krijimin e së drejtës, e cila do të jetë e njëjtë për të gjithë. Vështruar nga këndi negativ, nuk lejohet e drejta e pabarabartë për disa individë ose disa grupe. Pra, parimi i barazisë, nënkupton edhe të drejtën për barazi.”

Neni 3 i Kushtetutës poashtu ngërthen në vete edhe parimin e multietnicitetit, i cili është një nga parimet themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Siç përcaktohet qartë në këtë nen: “Kosova është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore”. Ky parim, megjithatë, mund të vihet në jetë vetëm përmes funksionimit të rregullt të institucioneve, e në veçanti legjislativit

dhe ekzekutivit. Në kushtet e një bllokade institucionale, komunitetet joshumicë e kanë të pamundur t'i realizojnë të drejtat e tyre kushtetuese dhe t'i shfrytëzojnë mundësitë për t'i avancuar ato më tej përmes politikave të ardhshme që do të propozoheshin nga Qeveria e do të miratoheshin nga Kuvendi. Pra, është e pakontestueshme se për ta jetësuar këtë koncept të mishëruar si detyrim por edhe vlerë kushtetuese, nevojiten institucione funksionale që garantojnë zbatimin e tij në praktikë. Në të kundërtën, bllokimi i konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nën arsyetimin e garantimit të të drejtave të komuniteteve mund të ketë efekt krejtësisht të kundërt meqenëse e pamundëson thuaja në tërësi realizimin dhe mbrojtjen e tyre në praktikë. Pra, edhe vetë koncepti i shoqërisë multientike është i pamundur të realizohet në një shtet jofunksional.

Neni 57 (4) i Kushtetutës i cili ka për qëllim parandalimin e abuzimit të të drejtave, është poashtu në linjë të plotë me rregullimin që parashihet në instrumentet kryesore ndërkombëtare. Siç dihet, Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut gëzon zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës, ndërkaj vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila e interpreton këtë Konventë janë poashtu drejtpërdrejtë të zbatueshme. Kjo meqë neni 53 i Kushtetutës parasheh se: “të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Kësisoj, neni 17 i Konventës Evropiane ka ndaluar shprehimisht abuzimin me të drejtat, duke theksuar se asnjë shtet, **grup** ose person nuk mund të angazhohet në aktivitete, të cilat kanë për synim shkatërrimin e ndonjë të drejte ose lirie të përcaktuar me Konventë.

Me një interpretim më të gjerë të kësaj dispozite në praktikën e pasur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe në ato të shteteve të tjera, është përcaktuar qartazi parimi se askush nuk mund t'i përdorë të drejtat e tyre për t'i minuar të drejtat e një grupi apo personave tjerë. Më konkretisht, në rastin *Refah Partisi kundër Turqisë*, Gjykata shprehimisht ka theksuar se: “*askush nuk mund të mbështetet në dispozitat e Konventës me qëllim që të dobësojë ose të shkatërrojë idealet dhe vlerat e një shoqërie demokratike.*” [*Refah Partisi dhe të tjerët kundër Turqisë*, paragrafi 99].

Tutje, duke elaboruar vetë qëllimin e përfshirjes së nenit 17 në Konventë, në rastin *Bîrsan kundër Rumanisë*, Gjykata ka deklaruar se “*neni 17 synon t'u japë vendeve demokratike mjetet për të luftuar veprimet dhe aktivitetet që shkatërrojnë ose kufizojnë në mënyrë të pajustificuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve, pavarësisht nëse këto veprime apo aktivitete kryhen nga shteti, një grup apo edhe një individ*” [*Bîrsan kundër Rumanisë*, paragrafi 68]. Ndërkaj, në rastet *Perinçek kundër Zvicrës* dhe *Ždanoka kundër Latvisë*, Gjykata ka theksuar se vetë qëllimi i përfshirjes së nenit 17 në Konventë ka qenë fakti se: “*nuk mund të përjashtohet mundësia që një person ose një grup personash të përpiqen të mbështeten në të drejtat e garantuara në Konventë për të nxjerrë prej tyre mundësinë për të kryer veprimtari të cilat shkelin pikërisht ato të drejta*” [*Perinçek kundër Zvicrës*, paragrafi 113; *Ždanoka kundër Latvisë*, paragrafi 99].

Në linjë me këtë, edhe Komisioni i Venecias në Opinionin Nr. CDL-AD (2005) 004 ka theksuar se kur vetot e minoriteteve nuk mbikëqyren, ato mund të shfrytëzohen në atë mënyrë që të prodhojnë paraliza institucionale, duke shkuar kështu në kundërshtim me qëllimin për të cilin janë paraparë në radhë të parë. Rrjedhimisht, Komisioni kishte gjetur se vetoja e një grupi është mekanizëm mbrojtës, por jo mjet politik për bllokim. Si e tillë, sipas Komisionit, është e nevojshme që ky mjet të kufizohet në atë mënyrë që të mos pengohet vendimmarrja.

Në rastin në fjalë kjo e drejtë po tentohet të përdoret në kundërshtim me qëllimin për të cilin është garantuar për një komunitet joshumicë. Megjithatë e njëjta, nëse lejohet, do të mund të përdoret edhe nga komunitetet e tjera dhe/apo nga grupet e tjera politike në të ardhmen. Pra, nëse çdo grupacioni që propozon një nënkryetar në procesin e funksionalizimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i garantohet një e drejtë e tillë e vetos në atë mënyrë që të parandalojë dhe paralizojë konstituimin e Kuvendit, atëherë kjo do të krijonte një precedent të rrezikshëm dhe një gamë të gjerë të mundësive për bllokim nga secili dhe në çdo kohë. Nëse kjo fuqi bllokuese i njihet cilësdo force politike, grupi parlamentar apo komuniteti joshumicë që ka të drejtën e propozimit të një nënkryetari, atëherë mundësitë e konstituimit të Kuvendit do të jenë shumë herë më të vogla sesa mundësitë për bllokimin dhe paralizimin e tij. Lejimi i një mundësie të tillë do ta fuste Republikën në një rreth vicioz nga i cili vështirë së mund të dilet, prandaj kjo gjë duhet të parandalohej me çdo kusht.

Prandaj, Republika e Kosovës nuk duhet dhe nuk mund të mbahet peng i asnjë partie apo komuniteti, në kuptimin që askush nuk mund të ketë të drejtën e vetos mbi funksionalizimin e institucioneve kushtetuese. Një mekanizëm i tillë do t'i rrezikonte vetë themelet e rendit demokratik dhe sovranitetin e shtetit tonë.

II. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk duhet të bllokohet si pasojë e veprimeve të cilësdo parti politike apo komuniteti

Që nga data 15 prill 2025, kur është thirrur seanca konstituive, Republika e Kosovës ka mbetur në një bllokadë të tërë shtetërore të shkaktuar si pasojë e vonesave në konstituimin e Kuvendit.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në një numër aktgjykimesh të saj që nga viti 2014, ka vënë theksin mbi frymën pozitive të konstituimit të shpejtë të institucioneve, e në veçanti Kuvendit, i cili është cilësuar nga vetë Gjykata si “organi më i lartë përfaqësues”.

Kështu, në Aktgjykimin në rastin nr. KO 72/20, Gjykata ka theksuar se: *“struktura e normave kushtetuese që ndërlidhen me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohen në atë mënyrë që të jetësojnë, dhe jo të bllokojnë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve përkatëse”*. Në të njëjtin Aktgjykim, Gjykata gjithashtu sqaron se *“asnjë normë kushtetuese nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të bllokojë themelimin dhe funksionimin efektiv të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv”*. Të njëjtat përcaktime, Gjykata i ka riafirmuar edhe në rastet e fundit lidhur me procesin e konstituimit të Kuvendit [Aktgjykimi në rastin nr. KO 124/25, paragrafi 109; Aktgjykimi në rastet nr. KO 193/25 dhe KO 196/25, paragrafi 152].

Konkretisht, në Aktgjykimin në rastin nr. KO 124/25, Gjykata shprehimisht ka cekur se: *“Vetë natyra e kësaj demokracie ndjek një lloj demokracie konsensusi, defavorizon dhe përjashton mundësinë që Kuvendi si organ përfaqësues të shndërrohet në legjislaturë jo funksionale si rezultat i bllokimeve procedurale.”* [Aktgjykimi në rastin nr. KO 124/25, paragrafi 116].

Në rrjedhë të këtyre interpretimeve nga vetë Gjykata si autoritet përfundimtar i interpretimit të Kushtetutës, është mjaftueshëm e qartë se interesi më i lartë i Republikës së Kosovës është funksionimi efektiv dhe i vazhdueshëm i institucioneve të saj, pa vonesa apo bllokime procedurale.

Përderisa përfaqësimi i komuniteteve është e drejtë dhe vlerë kushtetuese, një gjë e tillë nuk duhet të bllokojë konstituimin e institucioneve. Lidhur me këtë, në Aktgjykimin e fundit në rastin nr. KO 193/25 dhe KO 196/25, Gjykata Kushtetuese qartazi ka theksuar se: *“Gjykata kur trajton kushtetutshmërinë e një çështjeje të ngritur pranë saj, ajo merr për bazë Kushtetutën si tërësi, si dhe dispozitat themelore të saj në Kapitullin I të Kushtetutës, e që interpretohen në lidhshmëri me dispozitat kushtetuese të çështjes së kontestuar. Mbi këtë, Gjykata në raste të tilla, trajton kushtetutshmërinë e çështjes në kuptim të sundimit të ligjit dhe interesit të përgjithshëm dhe jo interesave subjektive të ndonjëres nga palët në procedurë”*. [Aktgjykimi në rastin nr. KO 193/25 dhe KO 196/25]. Tutje, në paragrafin 147 të Aktgjykimit në rastet nr. KO 193/25 dhe KO 196/25, Gjykata gjithashtu ka theksuar se: *“Kushtetuta dhe secila normë e saj duhet të interpretohen në ndërrvarësi me njëra tjetrën dhe jo të izoluar nga njëra tjetra”*, dhe se: *“asnjë normë kushtetuese nuk mund të nxirret jashtë kontekstit dhe të interpretohet në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës, për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera të saj”*.

Një frymë e tillë interpretimi ku interesi i përgjithshëm mbizotëron ndaj interesit të palëve në procedurë, duhet të ndiqet pikërisht në këtë rast, i cili afekton drejtpërdrejtë të gjitha parimet dhe vlerat themelore të mishëruara në Kapitullin I të Kushtetutës, që nga sovraniteti e deri te sundimi i ligjit.

Tutje, në Aktgjykimin e saj të fundit lidhur me konstituimin e Kuvendit, konkretisht në rastin nr. KO 193/25 dhe KO 196/25, Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar një mekanizëm zhbllokues, të cilin e ka cilësuar të domosdoshëm për përmbushjen e detyrimit kushtetues për konstituimin e Kuvendit dhe fillimin e funksionimit të tij si organi përfaqësues i sovranit [Aktgjykimi në rastet nr. KO 193/25 dhe KO 196/25, paragrafi 149]. Rrjedhimisht, fryma zhbllokuese duhet ta ndjekë edhe interpretimin lidhur me çështjen në fjalë, duke qenë se Kuvendi tashmë ka kryetar dhe katër nënkryetarë të zgjedhur, duke e bërë atë institucion plotësisht funksional, ndërsa është e qartë se ulësja e zbrazët vazhdon të mbetet e garantuar për komunitetin serb.

Në rastin konkret, komunitetit joshumicë serb i është dhënë mundësia e propozimit të kandidatit/es për nënkryetar/e disa herë në vazhdimësi. Komuniteti serb ka propozuar kandidatin e njëjtë, i cili është hedhur në votim tri herë, me ç'rast është dëshmuar se nuk i ka votat e nevojshme për zgjedhjen e tij. Pastaj, është provuar me të gjithë kandidatët e tjerë, por asnjëri nga kandidatët/et nga komuniteti serb nuk ka arritur t'i sigurojë votat e nevojshme për nënkryetar/e.

Në këtë pikë ekziston vakuum kushtetues lidhur me atë se çka ndodh kur një partie politike apo komuniteti joshumicë i shteren të gjitha propozimet, dhe asnjëri nuk i merr votat e nevojshme. Pikërisht në rrethana të tilla që ndërlidhen drejtpërdrejtë me funksionimin kushtetues të vendit, duhet të mbizotërojë fryma e interpretimit pozitiv të Kushtetutës..

Në rastin konkret, Kuvendi ka arritur ta sigurojë kuorumin e Kryesisë përmes zgjedhjes së numrit të nevojshëm të anëtarëve për një kuorum të tillë. Është absolutisht e qartë se vendi i zbrazët për nënkryetar/e të Kuvendit mbetet i garantuar për komunitetin serb, ashtu siç përcaktohet me nenin 67 (4) të Kushtetutës. Megjithatë, në interes të konstituimit të Kuvendit, konsiderojmë se përderisa është shterur mundësia për zgjedhjen e nënkryetarit/es gjatë seancës konstituive, kjo mundësi duhet t'i jepet përsëri komunitetit serb në cilëndo nga seancat e radhës së Kuvendit, deri në zgjedhjen e tij/saj, por pa e bllokuar konstituimin e institucionit. Kjo zgjidhje është në analogji me betimin e deputetëve, i cili në pamundësi për t'u realizuar gjatë seancës konstituive, mund të bëhet në seancat vijuese. Gjithsesi, moszgjedhja e një nënkryetari

në këtë fazë nuk duhet të lejohet ta bllokojë konstituimin e Kuvendit dhe as vazhdimin e punës së tij, përfshirë zgjedhjen e institucioneve të tjera që rrjedhin nga Kuvendi, si: Qeveria, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit e shumë institucione të tjera të domosdoshme për funksionimin e shtetit.

Siç u theksua tashmë, në raste të tilla, duhet të ndiqen parimet e përcaktuara nga vetë Gjykata, sipas të cilave, interesi i përgjithshëm mbisundon interesat e subjekteve të ndonjërës palë në procedurë, duke rikujtuar se: ***“nuk ka interes më të mirë të Republikës së Kosovës, se sa organi më i lartë përfaqësues të jetë i konstituuar dhe të fillojë sa më parë me funksionimin e tij dhe ushtrimin e kompetencave dhe detyrimeve të tij kushtetuese”*** [Aktgjykimi në Rastin KO Nr. 193/25 dhe KO Nr. 196/25, paragrafi 159]. Për më tepër, në Aktgjykimin në rastin nr. KO 124/25, Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës është përfaqësues i sovranit, ndaj rrjedhimisht idealet e sovranitetit të mishëruara në Kushtetutë mbeten zotime të papërmbushura në mungesë të funksionalitet të organit përfaqësues apo institucioneve tjera kushtetuese e shtetërore [Aktgjykimi në rastin nr. KO 124/25, paragrafi 105].

Praktikat e deritanishme të konstituimit të Kuvendit dëshmojnë se ka pasur një numër rastesh kur ky proces nuk është kushtëzuar me zgjedhjen e të gjithë nënkryetarëve në momentin e mbajtjes së seancës konstituive. Kështu, në tri raste të njëpasnjëshme, konkretisht në vitin 2001, 2004 dhe 2008, Kuvendi ishte konstituuar edhe pse nuk ishin plotësuar të gjitha pozitat e nënkryetarëve. Kësisoj, legjislatura e parë u konstituua edhe pse nuk ishin zgjedhur dy nënkryetarë nga partia më e madhe opozitare e asaj kohe; legjislatura e dytë u konstituua pa nënkryetarin nga komuniteti joshumicë serb, ndërsa legjislatura e tretë pa nënkryetarët nga radhët e dy komuniteteve joshumicë.

Pavarësisht faktit se tri legjislaturat në fjalë janë konstituuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, edhe në atë kohë ka ekzistuar një dispozitë e ngjashme me atë të Kushtetutës, e cila garantonte një pozitë për komunitetin joshumicë serb. Megjithatë, moszgjedhja e të gjithë nënkryetarëve të Kuvendit brenda seancës konstituive, nuk e ka penguar asnjëherë funksionalizimin e këtij institucioni, meqë vendet e zbrazëta janë plotësuar në seancat e radhës të Kuvendit.

Për fund, vlen të theksohet se kjo nuk është hera e parë që institucionet e Republikës së Kosovës të cilat kanë vende të garantuara për komunitetet joshumicë, përballen me bojkot dhe tërheqje nga një parti nga komuniteti serb. Në vitin 2022, pjesëtarë nga komuniteti serb në Kosovë kanë dhënë dorëheqje apo i kanë bojkotuar pozitat e tyre në Gjykata, Prokurori, Policinë e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, e madje edhe në vetë Kuvendin e Kosovës. Pavarësisht se pozitat e garantuara për pjesëtarët e komunitetit serb vazhdojnë të mbeten të garantuara për ta, një bojkot i tillë asnjëherë nuk është interpretuar si pamundësi e vazhdimin të funksionimit të këtyre institucioneve.

Në të njëjtën frymë, funksionalizimi i plotë i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe fillimi i ushtrimit të mandatit të tij kushtetues nuk duhet të mbahet peng i zgjedhjes së një nënkryetari/e nga cilado parti politike apo komunitet. Siç u përmend edhe më lartë, pavarësisht ezaurimit të të gjithë emrave për nënkryetarë nga komuniteti joshumicë serb në kuptim të seancës konstituive të Kuvendit, kjo pozitë do të mbetet e garantuar për ta deri në zgjedhjen e një nënkryetari në seancat e radhës të Kuvendit.

PËRFUNDIM

Në bazë të asaj që u argumentua më lart, si dhe duke pasur parasysh natyrën përfundimtare të interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata ka para saj mundësinë për ta përcaktuar një standard tejet të rëndësishëm për rastin në fjalë dhe secilin proces të ardhshëm të konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, me respekt kërkoj nga Gjykata Kushtetuese që të mos lejojë që cilado parti politike apo komunitet të ketë të drejtën e vetos në procese jetike për shtetin, siç është konstituimi i organit më të lartë përfaqësues të tij. Çdo përcaktim ndryshe, rrezikon që të legjitimojë bllokime procedurale të themelimit të institucioneve kyçe, në nivel të normës kushtetuese, juridikisht të detyrueshme.

Vetoja mbi Republikën nuk ka qenë kurrë as qëllimi i themeluesve të shtetit e as i hartuesve të Kushtetutës. Duke ia dhënë një partie politike që përfaqëson një komunitet veton mbi funksionalizimin e Kuvendit, e rrjedhimisht edhe të Qeverisë, Presidencës, e gati çdo institucioni tjetër shtetëror që zgjedhet në Kuvend, Republika do të zhvlehtësohej duke u shndërruar në një parim në letër, në vend se të jetë veprim i çdoditshëm në mbrojtje të sovranitetit e të interesave të të gjithë qytetarëve, pa dallim. Është në duar të kësaj Gjykate, që ta mbrojë shtetin nga rreziku që po i kanoset. Vendimi në rastin konkret nuk ka të bëjë thjesht me një pozitë të një nënkryetari nga komuniteti serb, por lidhet me funksionalitetin e shtetit tonë si tërësi. Në marrjen e këtij vendimi, shpresoj se do të udhëhiqeni nga mbrojtja e interesit më të mirë të Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën dhe siç ju ngarkon betimi që keni dhënë ndaj Republikës së Kosovës.

Me respekt,